

URDHËR
Nr. 51, datë 18.3.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të pikës 2 të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave drejtorit të përgjithshëm të Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin znj. Silvana Banushi, të praktikave të mëposhtme:

a) Nënshkrimin e kërkesave drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, drejtorive vendore të policisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit që aplikojnë për fitimin, rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe për shtetasit që kërkojnë heqjen dorë nga shtetësia shqiptare.

b) Kthimi i aplikimit të paraqitur në rastet e mungesës ose të pasaktësisë së dokumentacionit për shtetasit që aplikojnë për fitimin, rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe për shtetasit që kërkojnë heqjen dorë nga shtetësia shqiptare.

c) Trajtimin dhe nënshkrimin e kërkesave të ndryshme nga persona fizikë dhe juridikë, shtetas shqiptarë dhe/ose të huaj, për çështjet që lidhen me shtetësinë shqiptare.

2. Delegimin e vulës, drejtorit të përgjithshëm të Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin për praktikatat e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri.

3. Kompetencat sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij urdhri do të ushtrohen nga data 13.3.2025 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin.

5. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Politikave të Shtetësisë dhe Sektori i Arkiv-Protokollit.

6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 238, datë 27.5.2021, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha